

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1316 Prot.

Tiranë, më 28.12 2016

VENDIM Nr. 154, datë 20.12.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 14 të datës 20.12.2016, pasi shqyrtoi *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimeve arkeologjike* të shpëtimit në zonën me potencial arkeologjik Chance Find, Ullinjas KM 153+750-KM 153+250, të evidentuara gjatë punimeve për ndërtimin e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe verifikimin në terren të gjetjeve në këtë zonë, realizuar nga ASHA,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimeve arkeologjike të shpëtimit* në zonën me potencial arkeologjik Chance Find, Ullinjas KM 153+750-KM 153+250, të evidentuara gjatë punimeve për ndërtimin e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe verifikimin në terren të gjetjeve në këtë zonë, realizuar nga ASHA.
2. Për zonat me potencial të lartë arkeologjik, Chance Find, Ullinjas KM 153+750-KM 153+250, të evidentuara gjatë punimeve për ndërtimin e Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) si dhe atë të konstatuar së fundmi KM 151+300, të kryhen gërmimet arkeologjike të shpëtimit sipas Konceptit dhe metodologjisë së kryerjes së gërmimeve arkeologjike të shpëtimit të sipërcituar. Raporti i tyre të paraqitet në KKA e radhës.
3. Shoqëria "TAP AG" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të realizojë gërmimet arkeologjike të shpëtimit për zonat e sipërpërmendura, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO